

VENDIM
Nr. 412, datë 23.7.2025

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK
BASHKIA ELBASAN, TË PRONËS NR. 279, ME EMËRTIM “ISH-REPARTI
USHTARAK NR. 5012/38”, ME NUMËR PASURIE 17/65, NË ZONËN KADASTRALE
8522, PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Elbasan, të pronës nr. 279, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5012/38”, me numër pasurie 17/65, në zonën kadastrale 8522, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në funksion të projektit “Dua të luaj”.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Elbasan, të Qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Prona nr. 279, me emërtimin “Ish-reparti ushtarak nr. 5012/38”, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

4. Bashkisë Elbasan i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

FORMULARI I PËRDITËSIMIT

Identifikoi: Major Izet **Kamberi**, Specialist për Pronat, Rep. Usht. Nr. 4001

Major Tefik **Kambo**, Shef i Financës së Rep. Usht. Nr. 4006

Major Gazmend **Llangozi**, Specialist Logjistike në Rep. Usht. Nr. 4006

Supervizoi: Nënkolonel Arian **Shkurta**, Shef i Sektorit të Pronave, Rep. Usht. Nr. 4001

Aprovoi: Gjeneral brigade Aleksandër **Pando**, Komandant i Rep. Usht. Nr. 4001

Ministria e Mbrojtjes

Reparti Ushtarak Nr. 4001



Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative / pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall	Ndërtesë					
279	8522	17/65	Truall	Ish Rep. Usht. Nr. 5012/38, Shkumbin, Elbasan	23833.9	23833.92	2574.9	Për mbrojtjen	Reparti Ushtarak Nr. 4001	Reparti Ushtarak Nr. 4006	VKM nr. 515, datë 18.07.2003, ndryshuar me VKM nr. 220, datë 21.03.2017	
			Ndërtesë	Objekti nr.1			665.4					
			Ndërtesë	Objekti nr.3			373					
			Ndërtesë	Objekti nr.4			375.7					
			Ndërtesë	Objekti nr.5			375.7					
			Ndërtesë	Objekti nr.6			375					
			Ndërtesë	Objekti nr.7			410.1					
TOTAL					23833.9	23833.92	2574.9					

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr. 279 "Ish Reparti Ushtarak Nr. 5012/38" Shkumbin, Elbasan

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM

DATE 29.05.2025

QËLLIMI : Përditësim/Transferim

VENDNDODHJA

Bashkia Elbasan

DVASHK Elbasan

Nr.Pasurisë 17/65

Z.K 8522

Indeksi i Hartës EL; Q-10; P-10

TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë Truallë-Ndërtesë

Sip e pasurisë 23833.92 m²

Sip e gjurmës së ndërtimit 5484 m²

Nr. kateve

Nr. pemeve


Nord - 4551220.50

East - 507450.75

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord - 4551220.50

East - 507450.75



SHPIEGUESË:

Kufiri i Pronës

Sip.e Përgjithëshme = 23833.92 m²

Sip e përgj. e gjurmës së ndërtimit të objekteve = 2574.9 m²

8522

EL; Q-10

SH 1: 1000

Nord - 4551220.50

East - 507450.75

Nord - 4551220.50

East - 507450.75

SHORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFI	TIPI	KUFI
1	Vari				
2	Lindje				
3	Jug				
4	Perendim				

KUFI	TIPI	KUFI	TIPI
17/65	17/65	17/65	17/65
17/65	17/65	17/65	17/65
17/65	17/65	17/65	17/65

REALIZOI PËR IGJIU
Major Arjana Saliko
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI
MsC.Ark. Jergen COLAKU

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: O.Z.G.T
Shënim: Ky plan rievimi u hartua në zbatim të shkresës të Komandës Mbështetëse nr.1928/1, datë 12.05.2025, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, HTR, dokumentacionin b/lidhur shkresës dhe ortofoto e vitit 2015-2016.
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM

MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE
Gjeneral brigade Aleksander PANDU

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nombërimi
KONFIRMOI
Përgjegjës/Drejtori
Nombërimi/ Vula

